Në fund të inspektimit u përpilua Procesverbali me numër serik 0015697 i cili i është lexuar Palës dhe është nënshkruar nga Pala prezente pa ndonjë pretendim apo vërejtje, si dhe nga Trupa Inspektuese.

## II. Metodologjia

Metodat e përdorur gjatë inspektimit:

- **Intervistimi:** Bashkëbisedim me tekniken e farmacisë znj. Zurafet Sala.
- **Mbledhja e fakteve:** Licenca e Barnatores, Certifikata e Biznesit, Licenca e Farmacistes Përgjegjës, Licenca e Teknikes së Farmacisë.
- **Observimi:** Gjatë inspektimit janë kontrolluar dokumentacioni, produktet dhe pajisjet medicinale, prezenca e stafit profesional.

## III. Faktet

Me datë 11.04.2025 Inspektorati Farmaceutik ka kryer inspektim në barnatoren "Hikmet Krüezi B.I", me adresë: Rruga "Sahat kule sokak" Nr. 4, Mamushë - Prizren.

Gjatë inspektimit janë kontrolluar dokumentacioni, produktet dhe pajisjet medicinale si dhe prezenca e stafit profesional.

Barnatorja u gjet e hapur dhe shërbimi farmaceutik ofrohej nga teknikja e farmacisë znj. Zurafet Sala, me numër të licencës së punës KO-46583/A-05-4. Në barnatore nuk ishte prezent farmacistja përgjegjëse as ndonjë farmacist tjetër zëvendësues.

Subjekti në fjalë është informuar për Ligjin Për Çmimin e Produkteve Medicinale dhe Vendimin Nr. 208/XII/2024 për vendosjen e çmimeve komfor Listës Zyrtare të lëshuar nga Ministri i Shëndetësisë.

Përmes Procesverbalit me numër serik 0015697, Pala është urdhëruar që të operojë vetëm sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

## IV. Konstatimet

- Barnatore "Hikmet Krüezi B.I", Rruga "Sahat kule sokak" Nr. 4 Mamushë - Prizren, e regjistruar në ARBK me Numër Unik Identifikues 810175209, posedon licencë valide në AKPPM me numer L5-0152/19/03/2020, me pronar z. Hikmet Krüezi dhe farmaciste përgjegjëse znj. Arijetë Simitçia, me numer të licencës së punës RKS-0994-20, posedon licencë valide të veprimtarisë.

- Në kohën e inspektimit në barnatore nuk ishte prezent farmacistja përgjegjëse dhe as ndonjë farmacist tjetër zëvendësues, me ç'rast konstatohet se Pala ka vepruar në kundërshtim me nenin 14 (paragrafin 2) të Ligjit 04/L-190 për Produkte dhe Pajisje Medicinale, që përcakton: *"Barnatorja duhet të ketë gjatë gjithë orarit të punës farmacist/farmacistët e licencuar."*, nenin 26 (paragrafin 2) të Ligjit 04/L-125 për Shëndetësi, që përcakton: *"Barërat e përshkruara nga mjeku ose stomatologu mund të jepen vetëm nga ose në prezencën e farmacistit të licencuar."*, neni 6 (paragrafët 3 dhe 4) të Udhëzimit Administrativ (Shëndetësi) Nr. 11/2015 për Qarkulluesit Farmaceutik me Pakicë për Produkte dhe Pajisje Medicinale, që përcakton: *"Barnatorja mund të funksionojë vetëm në prezencë të farmacistit."* dhe *"Në rast kur farmacisti nuk mund të jetë prezent në barnatore, bartësi i licencës profesionale të barnatores është i obliguar që ta angazhojë farmacistin zëvendësues, i cili autorizohet për kryerjen e detyrave të farmacistit."*

- Subjekti në fjalë ka filluar me aplikimin e çmimeve komfor Listës Zyrtare, dhe është në vazhdim të procesit.

## V. Rekomandimet

- Urdhërohet që znj. Arijetë Simitçi, farmaciste përgjegjëse në barnatoren "Hikmet Krüezi B.I" të punon vetëm sipas legjislacionit përkatës në fuqi.
- Raportin e shoqëron Vendimi me gjobë numër 10/J-006/PF-25.
- Për plotësimin e rekomandimeve pala të njoftojë me shkrim Inspektoratin Farmaceutik.

Raportit i bashkëngjitet :

Kopja e Procesverbalit me numër serik 0015697.

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosova

*Qeveria-Vlada-Government*

Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health

Inspektorati Farmaceutik

## PROCESVERBAL I INSPEKTIMIT

0015697

(Nr. Serik)

11.04.2025 (Data e fillimit të inspektimit)

10:35 (Ora e fillimit të inspektimit)

Në subjektin: Barnatore "Hikmet Krüezi B.I." LS-0152/19/03/2020
ARBK: 810175209
(Emërtimi i subjektit të inspektimit)

I udhëhequr nga: & Hikmet Krüezi
(Emri dhe mbiemri i udhëheqësit të subjektit të inspektimit)

Në adresën: Mamushë Sahat kule sokak nr. 4 – Prizren
(Adresa e subjektit të inspektimit)

| Inspektimi është realizuar nga: | Me numër të dokumentit të identifikimit: |
|---|---|
| Jehona Zogaj | MSH – 0907 |
| Kaltrina Topalli | MSH – 1054 |
| (Emrat dhe mbiemrat e inspektorëve dhe personave të autorizuar për inspektim) | (Numri përkatës i dokumentit të identifikimit të inspektorit dhe të personave të autorizuar) |

Në informatat kontaktuese: jehona.zogaj@rks-gov.net
(Adresa elektronike e njërit nga inspektorët dhe numri zyrtar kontaktues)

Baza ligjore e inspektimit: Ligji 04/L-190, 04/L-125, 08/L-067, 08/L-220

Procesverbali përpilohet për: Me kohuse
(Lloji i inspektimit)

Inspektimi është bërë: me miratim [V] pa miratim [ ]

Inspektimi është bërë pa miratim përshkak të: /
(Arsyeja e inspektimit pa miratim)

(Nr. Serik)

Pranimi i miratimit të inspektimit është refuzuar nga subjekti i inspektimit: po [ ] jo [✓]
Ka munguar personi përfaqësues i subjektit të inspektimit: po [✓] jo [ ]
Miratimi i inspektimit është vendosur fizikisht aty ku është kryer inspektimi: po [ ] jo [✓]

Arsyeja për devijimin e inspektimit nga lista e kontrollit të inspektimit është:
Mbrojtja e shëndetit publik
(mbrojtja e interesit publik, shëndetit publik, sigurisë publike dhe/apo e mjedisit, nëse ka ndodhur)

Është inspektuar: [illegible]
produktet [illegible]
ligjit 08/L-210 dhe vendimit të Ministrisë [illegible]
(objekti i inspektimit, si për shembull lloji i dokumentacionit, i produktit, i objektit etj.)

Me rastin e inspektimit janë marrë: —
(mostrat e produkteve, materialeve, mallrave, substancave apo prodhimeve, nëse ka ndodhur)

Gjetjet e inspektimit janë: Barnatorja ishte e hapur dhe gjendej pa prezencën e farmacistit përgjegjës Mr. Ph. Arijete Sanihaj me nr. të licencës RKS-0994-20, apo farmacistit zëvendësues të licencuar. Prezent në barnatore ishte kujdestare farmaciste Zyf. Zurafet Sala me nr. të licencës KO-46583/17-05-n.
~~Pretendimet e subjektit të inspektimit janë:~~ Në barnatore ka filluar shitja i gminave të produkteve medicinale e pas lakë zyrtare të miratuar nga MSH.
(përmbledhja nga inspektori e shpjegimit dhe pretendimit të subjektit të inspektimit, pas dëgjimit të palës)

Subjekti i inspektimit ka vërejtje si vijon:
Nuk kam
(vërejtjet eventuale të subjektit të inspektimit sa i përket gjetjeve të inspektimit)

Vendimet e marra janë si vijon: Ndeshkim për mungesë të farmacistit përgjegjës, dhe atij zëvendësues të licencuar. Urdhëohet që të mbyllet barnatore dhe të merr e fuqint shërbim farmaceutik deri në paraqitjen e farmacistit përgjegjës.

Inspektimi ka përfunduar më datë: 11. 04. 2025, në orën: 11:05

Zurafet Sala
(nënshkrimi i subjektit të inspektimit apo përfaqësuesit të tij)

(nënshkrimet e anëtarëve të trupës inspektuese)